



FOKUS I  
*Albania - Kosova*

**Seria B**  
**Le të takohemi**  
**me Jezusin -**  
**Manuali**



# FOKUSI – Seri B - Manuali

## Le të takohemi me Jezusin

### Hyrje

Mirësevini në takimet e "Fokusit". Në këtë seri do të gjeni 5 tema. "FOKUSI" përdor katër shtylla për të strukturuar takimet. Çdo takim përbëhet nga disa elemente fikse, të cilat janë si më poshtë:



#### a. Studimi i Biblës

Së pari, ne duam të njohim Fjalën e Perëndisë duke studiuar së bashku një pjesë të Biblës. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me njohurinë dhe kuptimin më të mirë të asaj që shkruhet dhe çfarë do të thotë, por edhe për mënyrën se si mund ta zbatojmë atë në jetën tonë dhe se si përshtatet kjo pjesë e Biblës me përvojat tona.



#### b. Lutje

Lutja është themeli i gjithë serive të Fokusit. Duke u varur tek Perëndia, ne duam të arrijmë atë që Zoti mund të bëjë në mesin tonë dhe se si Ai mund të punojë përmes nesh. Prandaj, ne duam të lutemi për bekimin e tij, ta falënderojmë dhe ta adhurojmë. Në të njëjtën kohë ne duam të ndërmjetësojmë për njerëzit dhe situatat që po kalojnë.





### c. Në lëvizje

Është e rëndësishme të zbatojmë gjërat që do të mësojmë dhe zbulojmë në këto takime. Në këtë pjesë, propozohen hapa të vegjël që mund të bëjmë si një ushtrim në situatën tonë. Ndonjëherë personalisht, ndonjëherë si grup ose si kishë, ne do të inkurajojmë njëri-tjetrin që me të vërtetë ti zhvillojmë ato aktivitete duke bërë plane konkrete dhe më vonë duke pyetur njëri-tjetrin se si i kemi praktikuar ato plane.



### d. Ndarja e tregimeve

Në seksionin "Ndarja e tregimeve", ju jeni të ftuar të shprehni mendimet tuaja për Zotin dhe besimin dhe t'i ndani me të tjerët. Për më tepër, njerëz nga vende të ndryshme do të flasin për temat në video të shkurtra. Ata përpiqen të ecin me Perëndinë në rrethana të ndryshme, por të gjithë kanë pyetje dhe situata të ngjashme si ju.

### “Fokusi” është një proces shpirtëror

Ky material për grupet është pjesë e serisë “Fokusi”, e cila ka për qëllim të fillojë një proces reflektimi për të gjithë kishën, se si mund të jemi një kishë misionare me një përqendrim të përtërirë në Jezus Krishtin. Kjo seri e “Fokusit” është si një rrugë që ecim së bashku. Gjithsej janë gjashtë seri.

“Fokusi” është një proces mësimi i cili ka për qëllim të inkurajojë dy lëvizje:



- a. Një lëvizje në drejtim **të brendësisë**, drejt zemrës së kishës dhe drejt zemrës sonë personale. Ne do të flasim në thellësi se kush është Zoti në jetën tonë. Ne gjithashtu do të flasim për kuptimin e njohjes së Jezusit dhe të jetuarit me të. Si mund të jemi dëshmitarë besnikë në ditën e sotme? Kjo është një pyetje në radhë të parë për besimin tonë personal. Si mund ta lidhim besimin tonë në jetën tonë të përditshme: me punën tonë, me familjen tonë, me lagjen tonë, me miqtë tanë. Praktikisht: si mund ta lidhim besimin tonë në vendin dhe rolin që Zoti na ka caktuar.



- b. Lëvizja e dytë ka të bëjë me një lëvizje të përtërirë drejt **të jashtmes**. Ne i hapim sytë, zemrat tona dhe jetën tonë për njerëzit përreth nesh. Sidomos për njerëzit që ende nuk e njohin Jezusin. Ne do të kërkojmë këtë lëvizje të jashtme që nga fillimi i kësaj serie “Fokusi”. Në secilin mësim do të kërkojmë sesi mund të jemi të përfshirë në mënyrë praktike dhe aktive, kështu që nuk do të jetë thjesht një reflektim dhe diskutim i pafund.

### Sfondi

Qëllimi i serisë “Fokusi” është të mbështesë kishat në thirrjen e tyre misionare. Materiale të ndryshme janë zhvilluar duke dëgjuar me kujdes pyetjet e shumë të krishterëve dhe kishave.





Seria “Fokusi” nuk është vetëm një metodë, një strategji apo një program. Është para së gjithash një proces shpirtëror, një proces reflektimi, thellimi dhe ndryshimi.

Ne ndjekim **disa vlera kryesore** që shpjegojnë se çfarë është e rëndësishme në serinë "Fokusi":

#### **A. Kërkimi dhe përlësia**

Procesi fillon duke parë me ndershmëri situatën në veten tonë. Shpesh ne jemi të pasigurt në lidhje me sfidën e madhe të kishës për të qenë një kishë misionare në një shoqëri laike. Sekularizmi dhe mosinteresimi për besimin nuk është vetëm diçka jashtë nesh por ndikon edhe në jetën tonë dhe zemrat tona si të krishterë. Ka shumë besimtarë që janë shumë të rregullt me pjesëmarrjen në mbledhjet e kishave, por në zemrat e tyre nuk janë shumë seriozë me besimin e tyre. Kjo mund të na bëjë të ndihemi të pasigurt dhe të përlur. Kur flasim në serinë "Fokusi" për ndryshimin, ne flasim në radhë të parë për ndryshimin në jetën tonë. Është e nevojshme që së pari të përllemi para Zotit, që të jemi të sinqertë me veten tonë, pasiguritë tona dhe pamundësitë tona.

Ne mund t'i kapërcejmë këto probleme vetëm duke kuptuar se sa jemi të varur tek hiri i Zotit. *“Në qoftë se populli im, i cili thirret me emrin tim, përulet, lutet, kërkon fytyrën time dhe kthehet prapa nga rrugët e këqija, unë do ta dëgjoj nga qielli, do t'i fal mëkatën e tij dhe do ta shëroj vendin e tij”.* (2 Kronikave 7:14)



## B. Dëshira dhe pritja

Ne nuk duam të përqendrohemi në situatën aktuale ose ta pranojmë atë. Ne besojmë se dëshira për ndryshim dhe përtëritje vendoset në zemrat tona nga Fryma e Zotit. Ne besojmë në thirrjen e lartë që Zoti ka për kishën e tij. Kur dëshira përzihet me besimin, lind një qëndrim i pritjes. Ne nuk e presim atë nga angazhimi ynë, nga njohuritë ose veprimtaritë tona, por ne e presim atë vetëm nga Ai që na dërgon me fjalët: *"Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë ... dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës"*. (Mateu 28: 19,20). Fillon me të jetuarit në praninë e tij dhe besimi se asgjë nuk është e pamundur për Të.

## C. Përmbushja dhe rinovimi

Në Dhiatën e Re misioni nuk është vetëm një përkushtim, por edhe një premtim: *"Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut"* (Veprat 1: 8) Ne besojmë se dëshmia jonë do të sjellë fryte dhe se ndryshimi i vërtetë është i mundur vetëm përmes fuqisë së Frymës së Shenjtë, i cili na mbush dhe rinovon jetën tonë nga brenda. Në serinë "Fokusi" ne duam të kemi shumë kohë për lutje dhe duam të përqendrohemi në atë që vetë Zoti dëshiron të bëjë në ne dhe përmes nesh përmes Frymës së Tij.

## D. Thellimi dhe zgjerimi

Kur ne mendojmë për ungjillëzimin dhe një kishë misionare mendohen shpejt për modelet, metodat dhe aktivitetet e reja. Por ne besojmë se së pari duhet thellimi shpirtëror. Bëhet fjalë për zemrën tonë, besimin tonë, jetën tonë. Kush është Jezus Krishti për ne dhe si e jetojmë jetën tonë me Të? A i bëjmë gjërat tona gjatë javës, apo vërtet përpiqemi të imitojmë Krishtin në jetën tonë?



Përveç këtij thellimi shpirtëror, zgjerimi është gjithashtu i nevojshëm, në mënyrë që diskutimi për dishepullizimin dhe mënyrën e jetesës misionare të mos kufizohet në një grup të vogël anëtarësh të kishës, por që e gjithë kisha të përfshihet.

### **Pika të vëmendjes për një bisedë të mirë**

#### **Të gjithë marrin pjesë dhe mund të flasin**

Një bisedë e mirë fillon me të dëgjuar. Mundohuni së bashku të siguroheni që të gjithë në grup mund të flasin dhe që të gjithë të dëgjojnë.

#### **Roli i drejtuesit të bisedës**

Drejtuesi i bisedës nuk është eksperti i cili duhet t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve ose të përcaktojë nëse përgjigjet janë të drejta ose të gabuara. Ai / ajo është atje për të bërë bisedën dhe, nëse është e nevojshme, për ta thelluar atë. Ai / ajo gjithashtu monitoron kohën dhe ndihmon grupin të vazhdojë diskutimin.

#### **Pyetje personale**

Shumë nga pyetjet në këtë material nuk janë pyetje diturie, të cilave mund t'i jepet vetëm një përgjigje e saktë. Shumica e pyetjeve janë krijuar për të filluar një bisedë se çfarë do të thotë pasazhi i Biblës në situatën tonë personale. Pyetjet na ndihmojnë të zbatojmë Biblën në jetën tonë. Ne mund të ndihmojmë dhe inkurajojmë njëri-tjetrin në këtë.



#### **Dëgjimi i njëri-tjetrit dhe Zotit**

Përveçse duam të dëgjojmë njëri-tjetrin, ne natyrisht duam të dëgjojmë atë që Zoti dëshiron të na tregojë përmes Biblës dhe përmes Frymës të Tij. Për këtë arsye,



është planifikuar kohë për lutje. Le të marrim kohë të mjaftueshme për t'u lutur gjatë mbledhjes.

### **Në lëvizje**

Pjesa "Në lëvizje" është një pjesë e rëndësishme sepse është si një urë lidhëse midis asaj që diskutojmë në Bibël dhe praktikës së jetës sonë të përditshme. Jemi të inkurajuar të marrim hapa konkret. Ne mund të ndihmojmë njëri-tjetrin duke bërë plane sa më konkrete të jetë e mundur. Mos pyesni vetëm njëri-tjetrin se çfarë dëshironi të bëni, por edhe konkretisht: Ku, me kë, kur dhe si?

### **Ndarja e tregimeve**

Seksioni "Ndarja e tregimeve" është krijuar për të zbuluar se si Zoti i angazhon njerëzit dhe punon përmes tyre. Ne e bëjmë këtë duke dëgjuar tregimet e të krishterëve të tjerë, të cilët mund të jetojnë afër ose larg. Por edhe duke i thënë njëri-tjetrit se çfarë përvojash kemi me kryerjen e ushtrimeve nga seksioni "Në lëvizje". Është e rëndësishme që të dëgjojmë tregimin e personit tjetër, pa dhënë menjëherë komente ose këshilla të padëshiruara.

### **Kthehu te thelbi**

Qëllimi i këtij materiali diskutimi është që të bashkohemi në një fokus të ri. Një fokus të ri në Jezus Krishtin. Mundohuni të ktheheni përsëri në këtë gjë thelbësore, kur largoheni gjatë bisedës, ose kur futeni në diskutime rreth çështjeve dytësore.





### **Konfidencialiteti**

Jini të kujdesshëm me informacionin që dëgjoni nga njëri-tjetri. Sa më personale të bëhet biseda, aq më e vlefshme është. Por nëse i thoni gjërat personale, kjo ju bën gjithashtu të prekshëm. Prandaj, është e nevojshme një atmosferë e sigurt në të cilën të gjithë vlerësohen dhe besimi nuk tradhtohet.



### **Atmosferë e mirë**

Krijoni një atmosferë të mirë dhe të rehatshme. Bisedat duhet të zhvillohen në kishën e Krishtit. Ne e dimë se jo të gjithë njerëzit janë njësoj por Perëndia mund të punojë në njerëz të ndryshëm në mënyra shumë të ndryshme. Mahnituni me atë që ju jep Zoti. Ne e kuptojmë se në bisedat tona dhe detyrat konkrete që bëjmë, ne jemi plotësisht të varur nga Fryma e Zotit. Ai madje punon përmes pafuqisë sonë.

### **Lutje**

Lutja është një pjesë e rëndësishme e “Fokusit”. Ne besojmë se një seri e “Fokusit” ka vetëm kuptim nëse ajo zhvillohet me lutje. A doni të luteni për procesin e “Fokusit” në kishën tuaj? Më poshtë janë disa sugjerime lutjeje që mund të përdorni në grup ose në shtëpi.

### **Përrulje**

Në procesin e “Fokusit” është e rëndësishme të kërkonti falje. Ne duhet të jemi të sigurtë me Perëndinë dhe t'i tregojmë atij për vaktësinë tonë, ndrojtjen tonë, paaftësinë tonë dhe fajin tonë. Gjithë këto gjera janë në zemrat tona. Përmendeni këtë në lutje dhe kërkojini Zotit falje.



## Lutje

- Lutuni për programin “Fokusi” në kishë. Kërkojini Zotit të bekojë procesin. Mendoni për atë që dëshironi për procesin e “Fokusit”. Çfarë doni të ndodhë me veten tuaj? Po me kishën? Shprehi këto mendime tek Zoti.
- Lutuni për udhëheqësin e kishës dhe udhëheqësit e tjerë dhe rolin e tyre në proces.
- Lutuni për pjesëmarrësit në serinë “Fokusi”.
- Lutuni që Zoti të bekojë bisedat dhe t'i ndihmojë pjesëmarrësit të zbatojnë atë që mësojnë.
- Lutuni për anëtarët e Kishës dhe kërkoni nga Zoti që të ketë një takim të ri me Jezusin.
- Lutuni për njerëzit që takoni në jetën e përditshme që nuk e njohin Zotin akoma. Lutuni që ata të njihen me Jezus Krishtin.



## Falënderime

- Falënderoni Zotin për Atë që është dhe për çfarë Ai ka bërë për ne.
- Falënderoni Zotin për këtë seri të “Fokusit” në kishën tuaj.
- Falënderoni Zotin për kishën në të cilën jeni anëtarë.



## Tema e parë:

# Jezusi na fton



1. **Mirëpresim** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.

2. **Fillojmë me detyrën** për të zgjedhur një person që dëshironi të kërkonti diçka. Shembuj:



- Martin Luther King (*për shembull: "Si ishe aq guximtar në luftën kundër racizmit në SH.B.A?"*)
- Nënë Tereza (*"Si mund të përballeshe me kaq shumë varfëri dhe vuajtje?"*)
- Michelle Obama (*"Çfarë di për ish-presidentin amerikan që pothuajse askush nuk e di?"*)
- Diana Spencer (*"Pse mendon se ishe kaq popullor?"*)
- Martin Luther (*"Cili ishte problemi yt më i madh me Kishën Katolike Romake?"*)
- Papa Françesku (*"A besoni se je vërtet pa mëkat?"*)
- Jezusi (*"Cili ka qenë momenti më i vështirë për ty kur ishe në tokë?"*)
- Bill Gates (*"Ju jeni një nga njerëzit më të pasur në këtë tokë. Çfarë gjërash ju nevojiten që nuk mund t'i blini me para?"*)

**Pastaj vazhdojmë me** faqen 2 Hyrja. Për shumë njerëz, takimi me Jezusin është komplet jetë ndryshues.



3. **Lexojmë pasazhin e Biblës nga Gjoni 1.**

Pastaj mund të tregosh për predikimin e një pastori. Një vajzë kishte ardhur në kishë vetëm një kohë të shkurtër. Ajo u thirr përpara në skenë nga pastori. Pastori e pyeti: "Si erdhe në kishë për herën të parë?" Ajo tha: "Një shoqe më ftoi të vija në kishë". Shoqja ishte gjithashtu në kishë dhe u ftua të dilte



përpara. Ajo u pyet: “Si erdhe ti në kishë për herën të parë?”. “Përmes një kushëriri”, tha ajo. Ai ishte gjithashtu në kishë dhe doli përpara. Kush ju ka treguar për Jezusin? Një komshi ..... dikush nga shkolla ..... vëllai im .... ..... në fund ishin 10 veta në skenë.

Zoti mund t'i thërrasë njerëzit vetë, por Ai shpesh na përdor ne për të thirrur njerëz. A kanë edhe pjesëmarrësit përvojë me këtë? A janë thirrur ata vetë nga të tjerët? A u përgjigjën pozitivisht menjëherë, apo iu desh kohë? A kanë ftuar ata të tjerë?

#### 4. Ne shohim videon rreth këtij pasazhi biblik

Skanoni kodin QR ose shkonin te YouTube:

<https://youtu.be/9JJd7rv3wiQ>



#### 5. Lexojmë faqe 4 Takimi me Jezusin

#### 6. Pyetja 1

- Çfarë është e veçantë për ju në këtë pasazh biblik?

Ka disa përgjigje.

Disa flasin për pyetjen "Ku jeton?" A është kjo një pyetje që i bëni shpesh njëri-tjetrit? Çfarë nënkuptonin burrat me pyetjen e tyre? Ata ndoshta donin ta njihnin më mirë Jezusin. Përgjigja nga Jezusi ishte se ai i ftoi ata menjëherë dhe ata folën për gjithçka së bashku.

#### 7. Lexojmë tekstin në faqen 5





**8. Diskutojmë pyetjen 2** në grupe të vogla.

- Çfarë duam (presim) ne me të vërtet nga Jezusi?  
(përgjigja: Mbrojtje, dashurie, ta njohim më mirë, etj.)



**9. Diskutojmë pyetjen 3.**

(përgjigje: leximi i Biblës, lutja, adhurimi dhe biseda me besimtarë të tjerë, etj.)

**10. Lexojmë tekstin në faqen 6** (Andrea shkon te Simoni).

Kjo ka të bëjë me dëshirën për të ndarë me të tjerët atë që kemi parë dhe dëgjuar vetë.



**11. Diskutojmë pyetjen 4** (Mund të bëhet edhe në grupe të vogla).

Fokusi nuk është të argumentojmë, debatojmë por të japim një dëshmi personale, të shkurtër dhe të saktë. Ju kurrë nuk mund të fitoni një debat dhe njerëzit nuk binden përmes një debati. Kur debatojmë jemi të fokusuar në mendje, (në mendimet e tyre, logjikën) por është më mirë kur i takojmë njerëzit thellësisht në nivelin e tyre emocional (në zemër).



**12. Diskutojmë pyetjen 5.**

Ne duhet të respektojmë mendimin e të tjerëve. Nga ana tjetër, as nuk duhet të heqim dorë lehtë.



Pyesni njerëzit nëse ata që u treguan atyre për Jezusin, kanë hequr dorë lehtë kur përpiqeshin t'i ftonin në kishë? Me siguri jo. Nëse ata njerëz atëherë do të kishin hequr dorë me të vërtetë shpejt, ju mund të mos ishit ulur këtu sot.



### 13. Diskutojmë pyetjen 6.

Diskutoni veçanërisht pse Nathanaeli tani beson. Për shkak se Jezusi e bëri të ditur se Ai e njeh atë plotësisht.



14. **Shohim videon e JanCees**, pasi të kemi lexuar së bashku hyrjen në faqen 7 Skanoni kodin QR ose shkonin te YouTube:

<https://youtu.be/Eyo2f-K1pAs>



15. **Diskutojmë pyetjet në lidhje me videon e Jan-Cees**, shih pyetjen 7.



### 16. Lexojmë faqen 8 Në Lëvizje.

Mund të përmendni që ekziston një fjalë e urtë hebraike: “Nuk është rastësi që Zoti i krijoi njerëzit me vetëm 1 gojë dhe 2 veshë”. Kjo do të thotë që ne duhet të dëgjojmë dy herë më shumë sesa të flasim.

Mund të përmendni edhe ndryshimin midis pyetjeve të mbyllura (vetëm PO ose JO) dhe të hapura (duke filluar me Kush, Çfarë, Si, Pse, Ku etj.) Pyetjet e hapura janë shumë më tërheqëse për një bisedë vërtetë të thellë.



### 17. Mbyllja me lutje.



Tema e dytë:

## Jezusi na shikon



1. **Mirëpresim** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Fillojmë me pyetjen** se si shkoi ushtrimi me dëgjim më të mirë dhe një bisedë më të thellë. A funksionoi kjo?

3. **Lexojmë Prezantimi, f. 9 dhe 10.**

Kjo ka të bëjë me atë se sa shohim në ditë. Si të bëjmë zgjedhje? Në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme ne bëjmë zgjedhje për të lejuar imazhet / njerëzit të vijnë tek ne ose jo.

Kështu që ju mund të shikoni sipërfaqësisht ose me shumë vetëdije. Sot ne do të flasim për: Si i shikon Jezusi njerëzit dhe si mund t'i shohim ne njerëzit me sytë e Jezusit?



4. **Lexojmë Lukën 19 historia e Zakeut**

5. **Ne shohim videon rreth këtij pasazhi biblik**

Skanoni kodin QR ose shkonin te YouTube:

[https://youtu.be/ngLg\\_dMLozo](https://youtu.be/ngLg_dMLozo)



6. **Lexojmë faqen 11.**

Çfarë kupton në lidhje me këtë histori? (Zakeu nuk ishte i dashur, por Jezusi e pa atë. Ai madje e njohu atë me emër. Ai madje e pa atë në pemë. Ai donte të ishte me të në shtëpinë e tij. Zakeu u gjykua nga shumë, sepse ai ishte një tagrambledhës, i cili urrehet për arsyet e mëposhtme:



- Ai kërkoi para për të gjitha llojet e çështjeve të taksave, ai ishte "udhëheqësi" i mbledhësve të taksave;



- Ai bashkëpunoi me armikun, sundimtarin romak. Ai ishte tradhtar;
- Ai shpesh kërkonte shumë para dhe i vinte në xhepin e tij. Por Jezusi nuk e dënoi atë dhe donte të ishte me Zakeun në shtëpinë e tij. (Hebrenjve nuk u lejohej të hynin në shtëpinë e mëkatarëve dhe paganëve dhe të hanin me ta, sipas rregullave të farisenjve).

Ky interes i Jezusit bën që Zakeu të përjetojë dashuri dhe vëmendje dhe ai ndryshon për shkak të saj. Jo përmes një predikimi të gjatë ose një lutjeje të hollësishme. Zakeu u ndryshua nga vëmendja e dashuria e Jezusit dhe nga dy fjalë: Më ndiq !!!!



**7. Diskutojmë pyetjet 1 dhe 2 në grupe të vogla.**

**8. Lexojmë f. 12 Jezusi na shikon.**

Pastaj vazhdon me Psalmin 139. Edhe në barkun e nënës, Perëndia tashmë na njihte.



**9. Lexojmë f. 13, Psalmi 139.**



**10. Diskutojmë mbi pyetjen 3.**

Jezusi di gjithçka, të mirat dhe gjërat e vështira.

- A e besojmë vërtet atë?
- Si e përjetojmë atë? A është e bukur apo e frikshme?

**11. Lexojmë f. 14 Ndryshimi.**

Pyesni se si do të reagonin njerëzit nëse do të doje të vizitoje shtëpinë e dikujt? Do të ishte i mirëpritur apo jo? Menjëherë, apo i duhet pak kohë për të pastruar rrëmujën më parë? Si do të reagonim nëse Jezusi do të donte të na takonte? A ka gjëra që duhet të pastrojmë së pari në "Shtëpinë" tonë?



**12. Diskutojmë për pyetjen 4.**

**13. Lexojmë f. 14 dhe 15, I dënuar nga populli.**





Jezusi i shikon njerëzit ndryshe nga sa shumica e njerëzve e shikojnë njëri-tjetrin. Ai nuk gjykon. Është pikërisht ky qëndrim që bën që Zakeu të rrëfejë mëkatet e tij dhe të ndryshojë. Ai është çliruar nga lakmia e tij. Ai do të falet, Jezusi do të paguajë çmimin për shkeljet e tij.



**14. Diskutojmë për pyetjen 5 .**

Zakeu gjithashtu e sheh veten ndryshe.

- a. Kë njohim që ka ndryshuar plotësisht?
- b. Si është kjo në jetën tonë? A kemi ndryshuar shumë pasi kemi pranuar Jezus Krishtin? Në cilën drejtim?

**15. Lexojmë faqen 16 Jezusi e bën të njohur identitetin.**

Ai na jep një identitet të ri. Ai erdhi për të shpëtuar atë që kishte humbur.

**16. Shohim videon e Raaz dhe Promod.**

Skanoni kodin QR ose shkonin te YouTube:

<https://youtu.be/GignOQLRPZw>



**17. Diskutojmë për pyetjen 6.**

- a. Çfarë ju pëlqen në lidhje me këtë histori?
- b. A keni miqësi edhe me njerëz që nuk besojnë?





### 18. Në lëvizje:

Mendoni për pyetjen: Pse takoni disa njerëz dhe jo disa të tjerë? Si mund ta ndryshoni këtë?

A i shikoni me shikim të lartë njerëzit, apo i gjykoni? A mendoni se vleni më pak ose më shumë? Shikoni gjithashtu njerëzit në lagjen tuaj me të cilët keni pasur kontakt në një mënyrë ose në një tjetër. Lutuni për ta në mënyrë që t'i shihni vërtet! Përshëndetini me vetëdije dhe shikoni se çfarë do të ndodhë.



### 19. Mbyllim takimin me një lutje. Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkonti njërit prej pjesëmarrësve të lutet.



## Tema e tretë:

# Jezusi na flet



1. **Mirëpresim** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Ndarja e tregimeve**

Bisedë rreth temës se si mund t'i shohim të tjerët më mirë, përmes syve të Jezusit dhe si kemi folur me dikë. Ndoshta me dikë me të cilin kishim pasur vetëm kontakt sipërfaqësor deri më tani.

- A kemi folur me dikë që ende nuk e njihnim mirë?
- A ishte e vështirë?
- Çfarë kemi mësuar nga kjo?

3. **Ne lexojmë:** Prezantimi faqen 19 rreth asaj se si Jezusi na flet.



4. **Diskutojmë për pyetjen 1.**

- a. Cila pyetje rreth besimit dhe kishës ju duket një pyetje e bukur dhe do të donit t'i përgjigjeshit? (*p.sh. Kush është Jezusi, çfarë është e veçantë për besimin tuaj, pse shkoni në kishë, nga e dini nëse Zoti ekziston vërtet ?, etj.*)
- b. Cilën pyetje nuk do të preferonit t'ju bënin në lidhje me besimin / kishën tuaj? (*p.sh. situata me priftërinjtë që kanë përdhunuar fëmijët në Kishën Katolike Romake, pyetjet rreth trinitetit etj.*)

Mund të diskutoni këto pyetje në grupe të vogla ose në çifte nga dy.



5. **Lexojmë faqen 20** Tani dhe dëgjojmë mesazhin ..... Njerëzit dolën kundër Jezusit. Ata i rezistuan asaj që tha. (A duhet të merren ata gjithashtu me rezistencën nga jo-besimtarët në jetën e tyre?)



6. **Ne lexojmë faqen 21, Luka 4**

7. **Ne shohim videon rreth këtij pasazhi biblik**

Skanoni kodin QR ose shkonin te YouTube:

<https://youtu.be/NhYUA7Cp5TI>



8. **Lexojmë faqen 22**

Shpjegoni që Jezusi foli në sinagogë në shumë qytete. Shumë njerëz e dëgjuan Jezusin, por në qytetin e tij të Nazaretit, Jezusi përballët me rezistencë. Ata duan ta vrasin. Në një mënyrë shumë të veçantë, kjo në fund të fundit nuk ndodh.

Jezusi lexoi nga libri i Isaisë, kapitulli 61. Kur e lexoi kapitullin, Ai thotë: “Kjo ka të bëjë me mua. Unë jam përmbushja e profecisë”.



9. **Lexojmë faqen 23 Predikimi.**



10. **Diskutojmë për pyetjen 2.**

Pse njerëzit papritmas kanë ndryshuar mendje dhe duan të vrasin Jezusin?



*(Kjo pyetje nuk merr shumë përgjigje). Përgjigja është se njerëzit e mendojnë se ai është mendjemadh ose e akuzojnë atë për blasfemi.*

**Mund të pyesësh:** A e dinë se çfarë është blasfemi?

Blasfemia ka të bëjë me mëkatin më të madh që mund të bësh në ato ditë. Blasfemia është tallje me Zotin. Prandaj, hebrenjtë e konsideruan blasfemi që Jezusi e quan veten Mesia. Ata e shihnin Jezusin si një person normal. Në fund të fundit, blasfemia do të jetë gjithashtu arsyeja pse udhëheqësit hebrenj dëshirojnë që Jezusi të kryqëzohet më vonë.

### 11. Lexojmë faqen 23 Profeti në qytetin e lindjes.

Njerëzit e njihnin Jezusin që nga rinia e tij. Si është e mundur që Ai papritmas të thotë se Ai është biri i Zotit. Ata e njohin atë si fëmijë, si adoleshent dhe si burrë i rritur. Ai është biri i Jozefit, jo i Zotit.

Jezusi përgjigjet me 2 histori nga Dhiata e Vjetër në lidhje me atë se si Perëndia u kujdes për jo-hebrenjtë, kur hebrenjtë nuk do ta dëgjonin Zotin. Edhe tani ka një shans që lajmi i mirë për Mesinë t'u kalojë Judenjve nëse ata nuk e pranojnë atë. Kjo është arsyeja pse hebrenjtë acarohen shumë dhe duan të vrasin Jezusin. Si është e mundur që Zoti i do jo-hebrenjtë më shumë se Judenjtë?



### 12. Diskutojmë për pyetjen 3 (nëse ka kohë të mjaftueshme, kjo mund të bëhet në grupe të vogla).

- a. Çfarë mendimesh të çuditshme / të gabuara dëgjojmë ndonjëherë nga njerëzit kur flasin për Zotin ose Jezusin?*(p.sh. Disa njerëz mendojnë se Triniteti është me Perëndinë Atë, Marinë dhe Jezusin. Atëherë ata nuk kanë dëgjuar për Frymën e Shenjtë. Ose njerëzit mendojnë se Zoti është shumë larg. Ose që të gjitha fetë në fund të fundit janë të njëjta. Ose se Zoti është një Zot që i pëlqen të ndëshkojë).*
- b. Çfarë mendimesh të gabuara mund të keni pasur vetë? Si kanë ndryshuar mendimet tuaja për Zotin me kalimin e kohës? *(A jeni bërë më fanatik apo më i butë?)Shembuj:*




*Zoti nuk mund të falë disa mëkate / Nuk mund të jesh kurrë i sigurt për shpëtimin tënd / Nëse bëhesh i krishterë nuk do të kesh kurrë më probleme / Si i krishterë nuk mund të mëkatosh më)*

Le të jemi të durueshëm ndaj besimtarëve të rinj ose jobesimtarëve. Shpesh kërkon kohë që ata mund të kuptojnë se çfarë thotë Bibla në të vërtetë se kush është Zoti. Edhe ne si të krishterë nuk kemi pasur një ide të përsosur të Zotit dhe të besimit që nga fillimi. Kjo është diçka që duhet të rritet dhe të thellohet.

Nëse ka kohë, mund ta lexojmë historinë nga **Veprat 19** ku ndjekësit e Gjonit i tregojnë Palit se ata janë besimtarë dhe janë pagëzuar në emrin e tij. Por ata kurrë nuk kishin dëgjuar për Frymën e Shenjtë. Kjo është arsyeja pse ata më pas pagëzohen përsëri, pasi Pali ua shpjegoi këtë.

### 13. Lexojmë faqen 24 Përgjigje ndaj predikimit.

Njerëzit u zemëruan kur dëgjuan se Mesia i premtuar kishte ardhur edhe për jo-Judenjtë. Ata donin ta vrisnin Jezusin. Por për mrekulli, "Jezusi eci mes tyre dhe iku". Ne nuk e dimë saktësisht se si ndodhi kjo. Bibla nuk e shpjegon atë në detaje.



### 14. Diskutojmë për pyetjen 4

*(Kjo pyetje nuk merr shumë përgjigje. Nëse koha është e shkurtër, pyetja gjithashtu mund të anashkalohej.)*



- a. Cila është gjëja më e vështirë, e bezdisshme për ungjillin për jobesimtarët? *(Përgjigje: Njerëzit nuk duan thjeshtë të ndryshojnë traditat / Njerëzit nuk duan që dikush tjetër të zgjidhë problemet e tyre. Ata nuk duan të pranojnë se kanë nevojë për një Shpëtimtar. / Njerëzit mendojnë se nuk kanë bërë mëkate).*
- b. A arrijmë të kuptojmë diçka nga ajo rezistencë? Si ta trajtojmë atë?



**15. Lexojmë historinë e Arben Bitrakut, f. 25 dhe 26.**

Arbeni është një person i vërtetë, ashtu si të gjitha tregimet e tjera nga libra FOKUSI. Për arsye të privatësisë ne kemi ndryshuar emrin dhe foton e tij. Por historia është plotësisht e vërtetë.



Arbeni bëhet i krishterë, por përballet me rezistencë. Diskutoni pyetjet (në grupe të vogla nëse ka kohë)

- a. Çfarë mendoni për historinë e Arbenit?
- b. A u përballet ai me reagime negative kur u bë i krishterë? Si reagoi ndaj kësaj?
- c. Arbeni nuk dekurajohet. Si mund ta mbash besimin tënd dhe të mos dekurajohesh?



**16. Lexojmë “Në Lëvizje”, faqe 27.**

Jezusi e bën të njohur vetveten. Ai flet hapur se kush është. Ai përballet me rezistencë.

Shumë të krishterë e kanë të vështirë të jenë dëshmitarë për besimin e tyre. Ndonjëherë për shkak se ata përballeten me rezistencë.

- A është e vështirë për ju të flisni për Jezusin me njerëz nga lagjja ose familja juaj?
- A është tepër e vështirë të flasësh për këtë me njerëz që takon çdo ditë? Për çfarë keni frikë apo nuk jeni të sigurt? Çfarë mund të bësh në lidhje me këtë?



- Cilin anëtar të familjes apo person tjetër keni në mendje tani?
- Merrni kohë në shtëpi për të menduar për dikë që njihni mirë dhe me të cilin dëshironi të flisni për besimin.
- Lutuni për këtë person.
- Mendoni për një hap të mençur që mund të ndërmerrni për të filluar një bisedë dhe lutuni që Zoti t'ju ndihmojë për këtë.



**17. Diskutojmë për pyetjen 5.**

Çfarë përshkrimi ose mendimi do të donit të përdorni kur ndani ungjillin me të tjerët? Çfarë i përshtatet më mirë mënyrës suaj të dëshmisë?

(nëse ka shumë kohë, kjo mund të bëhet në grupe)



**18. Lutja.** Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkonti njërit prej pjesëmarrësve të lutet.





Tema e katërt:

## Jezusi na prek



1. **Mirëpresim** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Në lëvizje. Lexojmë faqen 29.**  
Kjo pyetje nuk merr shumë përgjigje, por është akoma mirë t'i bësh njerëzit të vetëdijshëm përsëri për të.



3. **Ne shikojmë videon e Vinicio.**  
Skanoni kodin QR ose shkonin te YouTube:  
<https://youtu.be/FG-urqqOumY>



Më pas ne do të diskutojmë pyetjet:

- Çfarë ju ka prekur në këtë video? Çfarë ishte e veçantë?
  - Çfarë ishte kaq e veçantë për Vinicio kur ai u përqaftua nga Papa. *(Ai përjetoi dashuri, vlerësim.)*
  - Çfarë efekti ka pasur kjo ngjarje në Vinicio dhe lagjen e tij? *(Ai ndihej më pak i izoluar. Të tjerët gjithashtu iu afruan më lehtë).*
4. **Lexojmë faqen 30. Prezantimi.**  
Jezusi shkon te njerëzit dhe i prek njerëzit për t'i nxjerrë nga izolimi. Ne gjithashtu mund të përpiqemi t'u afrohem njerëzve dhe t'i largojmë ata nga izolimi ose vetmia e tyre.



5. **Lexojmë Luka 5: 1-12**
6. **Ne shohim videon rreth këtij pasazhi biblik**  
Skanoni kodin QR ose shkonin te YouTube:  
<https://youtu.be/pLoxkojRbkY>



Njeriu me lebër. Jezusi shkon tek ai dhe e prek atë.

Një person me lebër ishte përjashtuar nga shoqëria normale në atë kohë. Ai duhej të jetonte jashtë qytetit në një lloj kampi, së bashku me njerëz të tjerë të sëmurë. Ata nuk kishin asnjë



kontakt me të afërmit, për shkak të rrezikut të infektimit. Ju mund të thoni se këta njerëz në të vërtetë ishin shpallur të vdekur ndërsa ishin ende gjallë.

Jezusi tregon fuqinë e tij duke shëruar njerëzit. Ai e ndihmoi këtë njeri të dilte nga izolimi i tij.

## 7. Lexojmë faqen 31 Shërimi.

### 8. Ne diskutojmë për pyetjen 1.

Jezusi e preku, ndërsa burri nuk e pyeti. Pse?

*(Jezusi dëshiron të jetë afër dhe të mos qëndrojë në distancë. Ai dëshiron të tregojë dashurinë e tij duke qenë afër. Vëmendja e vërtetë ndaj dikujt, ose një veprim ndonjëherë thotë më shumë se 1000 fjalë. Është mirë nëse edhe ne gjithashtu në kontaktet që kemi me njerëzit, ofrojmë një buzëqeshje, një përqafim, një shtrëngim duarsh, etj.)*

### 9. Ne lexojmë faqen 32 Mos i tregoni askujt

Rreth Jezusit ishin shumë njerëz që besuan në Të. Megjithatë, këta besimtarë ishin një pengesë për njeriun me lehtë. Ata e mbajtën distancën nga ky njeri dhe në fakt menduan se ky njeri nuk duhej të vinte tek Jezusi. Ndonjëherë ne si besimtarë ose si kishë jemi gjithashtu një pengesë që të tjerët të vijnë tek Jezusi.

### 10. Ne diskutojmë për pyetjen 2 (në grupe të vogla).

- a. Si mund të jemi (në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme) një pengesë?



- Ndonjëherë ne flasim shumë (si ata të Jehovahit për shembull) dhe njerëzit nuk mund të bëjnë vetë pyetjet e tyre. Ne nuk u japim atyre hapësirë të mjaftueshme për të folur.



- Ndonjëherë ne jemi të njëanshëm dhe me plot gjykime.
- Ndonjëherë ne jemi shumë të ftohtë dhe ka mungesë dashurie për jobesimtarët.
- Ndonjëherë ne shikojmë me përçmim për njerëzit që janë të rinj / të ndryshëm.
- Ndonjëherë të krishterët kanë një qëndrim të dyfishtë: Të dielën ata janë njerëz të mirë, por gjatë javës ne përdorim gjuhë të ashpër, bëjmë gjëra që nuk janë të drejta.
- Ndonjëherë thjeshtë nuk jemi të interesuar për të tjerët dhe mendojmë kryesisht për veten tonë.
- Ndonjëherë jemi krenarë që si të krishterë ndihemi më mirë se të tjerët.
- Ndonjëherë ne jemi shumë të përqendruar në rregulla, të cilat natyrisht një jobesimtar nuk mund t'i respektojë.

**b. Si mund të jetë një kishë pengesë?**

Nëse jemi shumë të zënë me organizimin e kishës dhe i harrojmë njerëzit.

**c. Si mund t'i përfshijmë njerëzit edhe më shumë?**

Ne duhet të përpiqemi ta shohim njëri-tjetrin si njerëz që të gjithë kanë nevojë për një Shpëtimtar.



**11. Ne lexojmë faqen 33, 34. Shërbeni dhe ndani**

Cilat grupe në shoqërinë tonë janë të vështira për tu arritur nga kishat? Si mund të filloni një aktivitet dhjakonal (shërbyes) për ta? Mos mendo një aktivitet shumë të madh, fillo me hapa të vegjël. Prsh një aktivitet me:

- Vejushat;
- Të varurit nga droga / alkooli;
- Të vetmuarit;
- Të moshuarit;
- Personat me aftësi të kufizuara;
- Të burgosurit dhe familjet e tyre.





Disa kisha janë tashmë aktive në lidhje me të varfërit, personat me aftësi të kufizuara, njerëzit me sindromën Down, të vetmuarit, njerëzit e prekur nga tërmeti, etj.



## 12. Lexojmë faqen 34 Në lëvizje

- Shpërndani letra të vogla. Pyesni njerëzit të shkruajnë çfarë kanë për të ofruar, me emrin e tyre. Lëri njerëzit të lexojnë ato që kanë shkruar. Ata mund ta mbajnë letrën për ti kujtuar vetvetes se çfarë po i ofrojnë kishës / shoqërisë.
- Pastaj bëni detyrën e dytë: Shkruani se si dëshironi të sfidoni dikë për të bërë diçka të re. Të gjithë shkruajnë diçka për dikë tjetër dhe e dorëzojnë këtë letër të palosur. Pastaj letrat shpërndahen rastësisht. (Shembuj: Unë dua që ju të luteni për... / Unë dua që ju të lexoni rreth... / Unë dua që ju të mësoni përmendësh këtë pasazh të Biblës / Unë dua që ju të ftoni një person të ri në kishë / Prediko këtë muaj në kishën tonë / Pastroni kishën / Kujdesuni për lulet në kopshtin e kishës / Përfundoni këtë takim me një lutje / Flisni me dikë që nuk beson për besimin tuaj këtë javë / Lexoni pasazhin e Biblës ... / Këndoni një këngë të dielën tjetër në kishë / ndihmo në takimin e fëmijëve)

Në disa kisha shkrimi nuk funksionon. Kështu që ne e bëmë atë në një mënyrë tjetër. Në grupe të vogla ose në çifte, flisni me njëri-tjetrin për dy pyetjet e mësipërme.



## 13. Mbyllim takimin me një lutje.

Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkonti njërit prej pjesëmarrësve të lutet.



## Tema e pestë:

# Jezusi jep jetën e tij për ne



1. **Mirëpresim** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Lexojmë faqen 35. Shërbeni dhe ndani.**
  - a. Pyesni shkurtimisht nëse ata kanë menduar për një aktivitet dhjakonalë në kishën e tyre?
  - b. Çfarë bënë ata me sfidën personale që morën herën e fundit?

Tema e këtij takim është: Jezusi jep jetën e tij për ne / Kryqi si qendra e dëshmisë sonë. Nëse duam të flasim me të tjerët për besimin tonë, është e rëndësishme që të kuptojmë se me çfarë ka të bëjë vërtet besimi ynë: **Vdekja e Jezusit në kryq**. Kjo është pjesa më e rëndësishme e besimit tonë dhe kjo është ajo që mund t'u themi të tjerëve. Shumë çështje të tjera të besimit janë më pak të rëndësishme nga krahasimi.

### 3. **Lexojmë: faqen 35, 36 Prezantimi.**

Pyesni njerëzit nëse ata kanë pasur ndonjëherë një medalje. Apo nëse ata njohin njerëz që kanë pasur një medalje? Si ishte në kohën e komunizmit? Njerëzit ndihen krenarë dhe të lumtur kur vlerësohen për atë që kanë bërë.

Jezusi nuk u pa si hero nga shumica e njerëzve.





#### 4. Lexojmë Luka 23.



#### 5. Diskutojmë për pyetjen 1

Çfarë ju prek më shumë kur lexoni këtë pasazh biblik  
Përgjigjet e mundshme:

- Jezusi tha: "Falini ata sepse ata nuk dinë se çfarë po bëjnë".
- Jam shumë mirënjohës që Jezusi nuk zbriti nga kryqi, përndryshe nuk do të kishte pasur shpëtim për ne.
- Njerëzit thanë: "Shpëto veten, trego fuqinë tënde..." Por Jezusi tregoi se nuk kishte të bënte me veten, por me planin më të madh të Perëndisë.
- Diskutoni gjithashtu, për shembull, lutjen që Jezusi bëri në kopshtin e Gjetsemanisë. Ai e pyeti Zotin: "Merre nga unë këtë kupë vuajtjeje". Jezusi ishte 100% Zot dhe 100% njerëzor dhe kishte frike për vuajtje. Për **fat të mirë**, kjo lutje e Jezusit nuk u plotësua. Nëse lutja e tij do të plotësohej, ne nuk do të ishim çliruar nga faji. Si t'i trajtojmë ne lutjet pa përgjigje? Është e vështirë, por le të besojmë se është mirë ashtu siç e dëshiron Zoti. Përmendni gjithashtu, për shembull, vuajtjet e Corrie ten Boom. Ajo humbi të gjithë të afërmit e saj në kampet e përqendrimit të Luftës së Dytë Botërore. Më vonë pas Luftës së Dytë Botërore ajo doli dhe foli rreth pyetjeve që ajo ka në lidhje me udhëheqjen e Zotit. Ajo përmendi shembullin e qëndisjes. Zoti sheh pjesën e përparme, ne shohim pjesën e prapme. Më vonë edhe ne do të shohim pjesën e përparme dhe do ta kuptojmë atë. Plani i Zotit është gjithmonë më i mirë, edhe nëse ndonjëherë nuk e kuptojmë vetë.

#### 6. Ne lexojmë faqet 38 dhe 39.

ME KUJTO



#### 7. Diskutojmë për pyetjen 2, në grupe të vogla.

(Ndonjëherë pjesëmarrësit e shohin këtë një pyetje të vështirë, por është një pyetje e bukur për grupet e vogla.



Qëllimi i kësaj pyetjeje është të afrojë vuajtjet e Jezusit. Nuk ka të bëjë aq me përmbajtjen e vetë pyetjeve.)

- Cilin nga kalimtarët do të donit ti bënit një pyetje?
- Çfarë pyetje do ti bënit?
- Çfarë përgjigje mendoni se do të kishin dhënë?

Përgjigjet e mundshme:

- Jezusit: Faleminderit / pse u kryqëzove / e dije si do të përfundonte?
- Marisë: Faleminderit, si është të shohësh djalin tënd që vdes në kryq, si është të jesh nëna e Shpëtimtarit?
- Udhëheqësve hebrej: Pse e keni kryqëzuar Jezusin, a kishit frikë nga njerëzit që donin ta ndiqnin Jezusin?
- Pilatit: Pse e dënuat Jezusin me vdekje?
- Judës: Pse e tradhtove Jezusin?
- Dishepujve: Pse nuk e mbrojtët Jezusin më mirë?
- Turmës: Pse donit të lironi Barabën dhe jo Jezusin?



8. **Shikojmë videon për kryqëzimin** e Jezusit me tekstin e një kënge shqiptare. Skanoni kodin QR ose shkonin te YouTube:

<https://youtu.be/WqOUmoWSB6M>



9. **Bisedoni me njëri-tjetrin për pyetjen 3**

- Çfarë do të donit t'i thonit Jezusit kur kujtoni se ai vdiq në kryq për mëkatet tuaja?
  - Shpesh thuhet: Faleminderit Jezus.
  - Ndonjëherë thjeshtë nuk ka fjalë për atë që Jezusi ka bërë për ne.



10. **Ne lexojmë historinë e Toe** (f. 40, 41).

Së pari shpjegoni se çfarë beson një budist. Ata besojnë në rimishërimin. Ju ktheheni në një jetë tjetër. Se si duket jeta juaj e ardhshme varet nëse jetoni mirë apo jo.



Qëllimi përfundimtar për një Budist është t'i shpëtojë atij rimishërimi të përsëritur.



**11. Ne diskutojmë rreth pyetjeve në faqen 42.**

- a. A keni përjetuar, si Toe, gjithashtu që jeni liruar nga një detyrim në jetën tuaj? (shumica e tyre flasin për çlirimin nga bestytnitë, drogën ose gjithashtu nga materializmi, traditat etj.)
- b. Toe është e kënaqur që është e krishterë dhe jo më budiste. Çfarë do të thonit nëse dikush ju pyet se pse besimi i krishterë është kaq i veçantë për ju? (Këtu mund të shpjegoni se Krishtërimi është feja e vetme ku ju me veprat tuaja nuk mund të afroheni tek Zoti, por Vetë Zoti me veprën e tij në kryq u afrua me ne. Ai bëri një rrugë për shpëtimin e përrjetshëm. Zoti është afër, ne mund të kemi një marrëdhënie personale me Zotin, ne tashmë mund të jemi të sigurt për shpëtim).




**12. Ne lexojmë faqen 42 Në lëvizje.**

Shumë njerëz nuk e dinë se çfarë janë Krishtlindjet, Pashkët etj. Është gjithashtu një arsye e mirë për të na treguar se çfarë do të thotë për ju që Jezusi vdiq në kryq.



**13. Mbyllja.**

Ne lexojmë Isaia 53. Pastaj ne do të qëndrojmë në një kohë qetësie për disa minuta. Një kohë vetëm ti dhe Zoti.







#### 14. Mbyllim takimin me një lutje.

Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkonti njërit prej pjesëmarrësve të lutet. Ose mund të thoni lutjen e faqes 41: "Ati ynë që je në qiej".





FOKUSI  
*Albania - Kosova*



[www.fokusi.al](http://www.fokusi.al)



Fokusi



[info@fokusi.al](mailto:info@fokusi.al)



0697013501